

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

ZHVILLIMI I TREGUT TË KAPITALEVE NË SHQIPËRI, SFIDAT DHE MASAT QË
DUHEN MARRË PËR NXITJEN E TIJ

Msc. Elona SHEHU¹
Msc. Sonila Nikolla²

Abstrakt

Bursa e Tiranës ka qenë tregu i vetëm i letrave me vlerë i autorizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer transaksione të këmbimit të aksioneve, por në të nuk u listua asnjë kompani deri në vitin 2017 kur edhe u vendos të mbyllej. Sektori bankar ka luajtur rol kryesor dhe të rëndësishëm në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri ku më shumë se 90% të aseteve të bankave në Shqipëri janë në pronësi të bankave të huaja. Nga ana tjetër, tregu i letrave me vlerë është ende i pazhvilluar.

Fondet e pensioneve private kanë një rol shumë të vogël në gamën e investitorëve institucionalë, tregu i obligacioneve të korporatave është i pazhvilluar dhe aktualisht, ka një numër të kufizuar fondesh investimi. Falë përvojës së pasur dhe bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Evropiane e Investimeve, rekomandimet e herëpashershme që ato i kanë dhënë AMF-së, ky Autoritet ka dhënë licencën për hapjen e bursës me kapital privat ALSE, e cila fillimisht pretendohet të ketë një numër të kufizuar titujsh të tregtuar për shkak edhe të riskut me të cilin përballlet ky sektor në Shqipëri.

Për realizimin e këtij punimi janë marrë në konsideratë të dhëna dhe analiza zyrtare dhe rekomandime nga institucione financiare ndërkombëtare.

***Fjalë kyçe:** treg kapitali, risku, letra me vlerë, shoqëri sigurimesh, fonde pensionesh, korporata.*

¹ elonashahini@umsh.edu.al

² Sonila.nikolla@umsh.edu.al